

Nxënësi nga American School of Kosova fiton BURSË TË PLOTË 4 VJEÇARE në UNIVERSITETIN e HARVARDIT

I gjithë vendi po i gëzohet lajmit për suksesin e Drin Krasniqit, studentit të vitit të katërt në Shkollën Amerikane në Kosovë, të cilit iu dha një mundësi e jashtëzakonshme për të ndjekur endrrën e tij.



HARVARD COLLEGE
Admissions & Financial Aid

#ASKPRIDE
@harvard

Dear Drin,

Congratulations! I am delighted to inform you that the Committee on Admissions has admitted you to the Harvard College Class of 2022 under the Early Action program. A transformative college experience awaits you here.



Welcome to Harvard! • HARVARD UNIVERSITY

Drin Krasniqi, student i vitit të fundit të shkollës së mesme në Shkollën Amerikane të Kosovës, është fitues i bursës së plotë 4 vjeçare për studimet universitare në Harvard, duke filluar nga viti i ardhshëm. Kjo bursë mbulon shpenzimet e udhëtimit, shpenzimet personale, 4 vitet e shkollimit, akomodimin dhe ushqimin; vlerë kjo mbi \$300,000. Shkolla Amerikane e Kosovës është krenare dhe e privilegjuar që ka kontribuar në një arritje të tillë. Drini ka treguar sukses të jashtëzakonshëm gjatë studimeve të tij në ASK dhe tani ai po e ndjek ëndrrën e tij për të qenë në mesin e mendjeve më të ndritura në botë.


Në një intervistë më të detajishme, Drini flet në lidhje me rëndësinë e sistemit amerikan të arsimit dhe rolit të ASK-së në zhvillimin dhe suksesin e nxënësve të saj.

Pse e zgjodhe Harvardin?

“Harvard gjithmonë ka qenë shkolla e ëndrrave. Për herë të parë për Harvardin kam dëgjuar nga filmat, ku përmendej si universiteti më i mirë në botë. Dy motrat e mia, të cilat kanë vijuar gjithashtu studimet në Shkollën Amerikane në Kosovë, vlerësojnë lartë rëndësinë e sistemit amerikan të arsimit, kështu duke më shtyer edhe mua të ndjek rrugën e tyre. Harvard është zgjedhja ime e vetme duke marrë parasyshë programet e



llojlojshme të studimeve të larta, ndihmave financiare dhe mbi të gjitha mundësinë që Harvard të ofron për të krijuar kontakte me gjithë botën. Të jesh pjesë e Harvard, do të thotë të jesh një nga mendjet më të ndritura në botë, ku do të kem rastin të mësoj shumë jo vetëm nga profesorët më të shquar, por edhe nga studentët më të dalluar. Konvikti i mrekullueshëm është gjithashtu një nga arsyet përse zgjedha Harvard.”



Si të ka ndihmuar/përgatitur ASK drejt këtij suksesi?

“Kur iu bashkova ASK-së në klasën e 10-të, kuptova që u bëra pjesë e një sistemi tërësisht ndryshe të shkollimit nga ai që isha më parë. ASK më mësoi si të jem lider në një moshë shumë të re, aftësi kjo që e posedojnë pothuajse të gjithë nxënësit e ASK-së. Shkolla amerikane bën përpjekje të vazhdueshme që të inkurajojë nxënësit të ngrisin zërin, si dhe i përgatisin ata që të jenë ndryshimi pozitiv i vendit. Përveç mësimdhënësve, të cilët janë gjithmonë aty për nxënësit edhe pas përfundimit të orarit mësimor, ASK më ka ofruar shumë mundësi të tjera, duke filluar nga pjesëmarrja në

klube të ndryshme deri tek organizimi i aktiviteteve të ndryshme shkollore.”

Çka do t’iu thoje nxënësve/studentëve kosovarë?

“Do t’iu thoja që çdo gjë është e mundur, përderisa punoni për të. Harvard dhe universitetet tjera si Stanford, Yale ose MIT nuk janë vetëm për gjenitë ose për ata që fitojnë milionat çdo muaj. Këto shkolla gjithmonë synojnë të kenë studentët më të ndritur, nga vende të ndryshme të botës, të cilave keni mundësinë të ju bashkoheni edhe ju, po qe se punoni shumë në atë drejtim.”

Cilat janë qëllimet tua pasi të përfundoni studimet në Harvard?

“Pasi që të përfundoj studimet në Harvard, planifikoj të kthehem në Kosovë dhe me dijen e fituar atje, të ndihmoj edhe më shumë zhvillimin e vendit. Do të përkushtohem veçanërisht që të ndihmoj të rinjët kosovarë të pranohen në Universitet prestigjioze botërore, kështu duke rritur numrin e të rinjëve Kosovarë që kanë vijuar studimet në universitete si Harvard, Yale, Stanford, Princeton etj. Kjo do të bënte që studentët e

tillë, do të shtyenin vendin drejt arritjeve dhe sukseseve të mëdha, qëllim ky imi, mirëpo edhe i ASK-së, kur bëhet fjalë për liderët e së ardhmes.”

Drin Krasniqi është njëri nga shumë liderë të së ardhmes në Kosovë, që kanë përfunduar studimet e tyre në Shkollën Amerikane në Kosovë. ASK gjithashtu mburret me suksesin e ish studentëve të saj, të cilët kanë fituar bursa të plota në shumë universitete të njohura të botës dhe që tanimë kanë sjellur ndryshimin në vendin tonë. Ndër më të suksesshmit janë: Agon Gashi - 2007, Bard College, NY; Agon Kastrati - 2012, Dartmouth College; Plarentina Desku - 2009, American University në Washington DC; Rea Dika - 2015, Webster University, Gjenevë; Fëllanza Limani - 2006, Kingston University, UK; Doruntina Hasani - 2010, Regents University, UK; Gresa Balaj - 2006, Emerson College, Boston, SHBA; Anita Gashi - 2015, Webster University, Holandë.

ASK ndjek kurrikulën amerikane sipas standardeve të unifikuara nga Common Core dhe AERO, (American Education Reaches Out). ASK përpiqet vazhdimisht të edukojë dhe përgatisë nxënësit në arritjen e synimeve të tyre, duke i ofruar çdo nxënësi mësim kualitativ në një ambient të ngrohtë dhe të sigurtë, që mundëson mendim kritik, bashkëpunues dhe efikas.